



SI TE PLOTESOHET PROJEKT FORMULARI I CORAL INVESTMENT

Ky instruksion përmban shpjegime dhe të dhëna për plotësimin e formularit që CORAL përdorë për të mbledhur informata lidhur me projektet investive që kërkojnë partneritet me një investitor të huaj. CORAL mund t'i ofrojë informatat të cilat ju na i dërgoni tek një investitor i huaj në mënyrat si në vijim:

- **Nëpërmjet bazës së të dhënave të projekteve investuese në web-site-in e CORAL;**
- **Nëpërmjet aktiviteteve promovionale të përgjithshme dhe sektoriale të ndërmarra nga CORAL ose institucioneve të tjera me qëllim të promovimit të potencialit investues regjional;**
- **Duke ofruar informacion drejtpërdrejt investitorëve potencial ose ndërmjetësuesve të tyre si përgjegje kërkesave specifike lidhur me mundësitë investive në Evropën juglindore;**

Para plotësimit të formularit, duhet të keni parasysh aspektet kyçe të projektit investiv:

- **Deri në çfarë mase projekti është financiarisht dhe nga aspekti komercial atraktiv dhe përfitues për investitorin e huaj potencial?** Nëse projekti nuk i përmbushë këto kritere bazë, është më pak e mundur që investitori i huaj do të investojë në projekt të tillë.
- **Cilat janë format e bashkëpunimit të cilat dëshironi t'i arrini me investitorin e huaj?** Pavarësisht se sa atraktiv është vet projekti, një investitor i huaj do të dëshirojë të ruaj një formë të kontrollit mbi investimet e bëra dhe do të kërkojë nga ju të hiqni dorë apo të ndani përgjegjësitë nga biznesi ekzistues apo aktiviteti. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ju duhet të konsideroni me kujdes se çfarë marrëveshje të pranueshme nga të dyja palët mund t'i propozoni investitorit të huaj potencial.
- **Cili është niveli i ofruar i fleksibilitetit në definimin e projektit investiv?** Shumë pak investitorë të huaj do të shohin të investojnë në projekt propozimin original. Edhe nëse vet projekti është atraktiv, investitorët e huaj do të duan të bëjnë ndryshime të caktuara për t'iu përshtatur modelit të tyre të bërit biznes.
- **Sa jeni të përgatitur për të ofruar investitorit të huaj potencial informata shtesë lidhur me projektin?** Nëqoftëse një investitor potencial shfaqë interes në projektin tuaj investiv, ai/ajo pret nga ju të jeni në gjendje të ofroni informata shtesë lidhur me vet projektin dhe lidhur me biznesin tuaj. Kjo vlen për studimin e fisibilitetit, analizën financiare të projektit të propozuar, llogaritë financiare dhe dokumentacionin e biznesit. Nëse këto informata nuk janë të çasshme, ju duhet të ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që të jeni në gjendje të prezantoni informatat e kërkuara investitorit potencial në afat të shkurtër kohor.

Është e rëndësishme që ju të plotësoni formularin komplet dhe të na ofroni të gjitha informatat në mënyrë të saktë dhe precize në secilën pjesë. Vetëm nëse i kemi të gjitha informatat lidhur me projektin, ka më shumë gjasa që një investitor do të vlerësojë projektin tuaj si atraktiv dhe mundësi të mirë-dizajnuar. CORAL do të vlerësojë përmbajtjen dhe statusin e implementimit të projektit dhe do të promovojë projektin tuaj investitorëve të huaj potencial.



Vendosni këtu një foto të projektit, kompanisë, komunës ose lokacionit (1-3 foto)	
Titulli i Projektit	Vendosni titullin e saktë të projektit të propozuar. Titulli duhet të jetë i shkurtër. Duhet të theksojë përmbajtjen e projektit dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim në identifikimin e projektit. Qëllimi i projektit duhet të jetë i dukshëm në titull (jo më shumë se 10 fjalë).
Sektori	Ofroni informatë për industrinë dhe sektorin të cilit i takon projekti. Industria e energjisë, industria e metalit, industria e drurit, industria e tekstilit, bujqësi, patundshmëri, turizëm, inovacion, teknologjia ICT, Start-up, projekt qeveritar (infrastrukturë, etj.), projekte të tjera.
Lokacioni	Ofroni informatë për lokacionin ku do të zhvillohen aktivitetet e projektit. Shënoni rajonin, kantonin, qytezën, qytetin afër të cilit do të zhvillohet aktiviteti. Nëse një pjesë e aktivitetit do të implementohet jashtë vendit, duhet të specifikohet qartë.
Përshkrimi i lokacionit	Nënvizoni gjeografikisht ku është vendndodhja, distanca nga ndonjë qytet i madh, çasja në infrastrukturë rrugore, çasja në tregje, autostrada, kufinj të shtetëror, distanca nga aeroporti, portet tokësore dhe detare, etj.
Përshkrim i kompanisë, komunës, asociacionit të biznesit	Përshkruani afarizmin e kompanisë, kur është themeluar dhe nëse ka ndonjë përvojë në aktivitetet ekonomike të ndërlidhura me idenë e biznesit. Nënvizoni nëse komuna mund të ofrojë informata lidhur me kapacitetet ekonomike dhe aktivitetet ekonomike që janë të ndërlidhura me projekt propozimin.
Statusi i Projektit	Ofroni informata lidhur me statusin e projektit në kuptim të nivelit të përgatitjeve të kryera lidhur me implementimin e investimit. Mund të jetë koncept projekt (ide e biznesit), projekt për të cilin ka përfunduar studimi i fisibilitetit ekonomik dhe financiar apo nëse implementimi i projektit është në realizim e sipër. Shembull: faza konceptuale, projekti është në realizim e sipër, në përgatitje të dokumentacionit, në procesin e zgjidhjes së çështjeve pronësore, në proces të marrjes së licensave dhe aprovimeve, në pritje, në proces të vlerësimit, në procesin e kontraktimit, i përfunduar, etj.
Dokumentacioni i Projektit	Listoni punët preliminare, proceset apo studimet të cilat duhet të kryhen lidhur me projektin si dhe dokumentacionet, licensat dhe aprovimet që duhet të merren nga autoritetet kompetente. Shembull: studimi para-investues, studimi i fisibilitetit me analizë të përfitimit, specifikacionet teknike, dizajni preliminar, dizajni kryesor, dizajni i detajuar, leja lokale, leja e ndërtimit, vendimi lidhur me kushtet e ndërtimit, studimi ambientor, të tjera (të specifikohen), shënime të tjera.
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit	Ofroni informata lidhur me rëndësinë e projektit në kuptim të arritjes së objektivave të përgjithshme dhe të veçanta, listoni të gjitha elementet e rëndësishme. Shpjegoni qëllimin dhe arsyetimin e projektit dhe shënoni se çka mëtoni të arrini me këtë projekt, duke filluar nga gjendja aktuale deri tek ajo e dëshiruar.



INFORMACION LIDHUR ME BARTESIN E PROJEKTIT	
Titulli i bartësit të projektit (Kompani, asociacion biznesor, komunë, qytet, rajon, kanton)	Titulli zyrtar nga regjistri
Forma Organizative	Kompani tregtare, shoqatë kooperative, tregti, fermë familjare - Mikro ndërmarrje (0-9 punëtorë) - Ndërmarrje e vogël (10-99 punëtorë) - Ndërmarrje e mesme (100-499 punëtorë).
Adresa	Rruga dhe numri
Lagjja dhe zip kod	
Qyteti apo qyteza/Komuna:	Emri i qytezës, qytetit apo komunës ku është i vendosur bartësi i projektit
Kantoni	Emri i kantonit ku është i vendosur bartësi i projektit
Personi kontaktues	Emri i personit që mund të ofrojë më së shumti informata lidhur me projektin.
Numri i telefonit	Shënoni numrin e telefonit të personit kontaktues
Telefoni mobil	Shënoni numrin e telefonit të personit kontaktues
Web faqja	Shënoni web faqen e kompanisë, asociacionit të biznesit, qytetit, komunës, etj.
E-Mail adresa	Shënoni e-mail adresën e personit kontaktues
PARTNERET E TJERE NE PROJEKT	
Personi Kontaktues	Emri i personit kontaktues
Numri i telefonit	Shënoni numrin e telefonit të personit kontaktues
Telefoni mobil	Shënoni numrin e telefonit të personit kontaktues
Web faqja	Shënoni web faqen e kompanisë, asociacionit të biznesit, qytetit, komunës, etj.
E-Mail adresa	Shënoni email adresën e personit kontaktues



TE DHENA BAZIKE LIDHUR ME PLANIN FINANCIAR TE PROJEKTIT		
Shuma totale e vlerësuar e nevojshme për implementimin e projektit investues - shuma totale e nevojshme për realizimin e objektivave të projektit në fjalë, përfshirë vlerën e investimeve tashmë të përfunduara – vlera e shprehur në euro (€)	Vlera (€)	
Të hyrat e planifikuara nga burimet dhe shuma e financimit	Burimi	Vlera (€)
	Burimet vetanake	
	Investitor privat	
	Investitor institucional	
	Bankat komerciale	
	Bankat Zhvillimore	
	Ndihmë shtetërore	
	Fonde të BE-së	
	Burime të tjera	
	Totali	
Përshkrim i fondeve të siguruara nga partnerët vendor	Ofroni informata lidhur me fondet (gjëra individuale) që ju apo një partner vendor si projekt-propozues keni investuar në implementimin e projektit. Ofroni detaje të ndonjë kushti specifik, incentive (shtytës) apo përfitimi që mund t'i ofroni ndonjë investitori të huaj.	
Shuma e kërkuar nga një investitor	Vlera	Përshkrim
	Shprehni në vlerë në euro (€)	Ofroni informatë lidhur me gjëra dhe fonde të cilat i kërkonin nga investitori i huaj për implementimin e projektit.
Forma e bashkëpunimit me partnerin e huaj	Financiare	Teknike
	Specifikoni formën e bashkëpunimit me investitorin e huaj në kuptim të aspektit financiar të projektit të propozuar.	Specifikoni formën e bashkëpunimit me investitorin e huaj në kuptim të aspektit teknik (jo-financiar) të projektit të propozuar.